



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 59, Datë 28-04-2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 31.03.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 31.03.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 31.03.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 31.03.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 22

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 22 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraj Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Fillimisht doja të thoja që për arsye shëndetësore sot kemi disa mungesa, në të cilat përfshihet edhe sekretarja e Këshillit, e cila do të zëvendësohet nga një anëtar i Komisionit të Rregullores. Për të vazhduar më tej, ka diçka nga këshilltarët apo ekzekutivi për rendin e ditës? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KALUAR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika mbi procesverbalin e mbledhjes së kaluar, ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E DORËHEQJES TË ANËTARIT TË KËSHILLIT Z.ANDON SHKODRANI.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika e 3 e rendit të ditës ka të bëjë me një dorëheqje që është bërë nga një prej këshilltarëve, nga z.Andon Shkodrani. Komisioni i Mandateve z.Gjergji Kristo mund të vazhdoni.

Këshilltari Gj.Kristo Në zbatim të gjermës (b) të nenit 49 si dhe gjermës (j) të nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, të gjermës (c) të pikës 1 të nenit 15 si dhe të gjermës (a) pika 3 të nenit 56 të rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me Vendimin nr. 80, datë 30.07.2020 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit Bashkiak Korçë", i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Korçë miratimin e dorëheqjes nga mandati të paraqitur nga z.Andon Shkodrani, kandidat i listës shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Sekretari i Këshillit do të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Këshill pas largimit të z.Andon Shkodrani.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Këshilltare I.Nikaj: Unë do doja të dija çfarë ka bërë Andoni gjatë kësaj kohe që ka qënë këshilltar, si ka kontribuar dhe një argumentim të dorëheqjes së tij mund të kemi?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ai ka paraqitur një dorëheqje me shkrim, të ngjashëm me ato që bëjnë në parlament, tani s'kemi çfarë t'i komentojmë dorëheqjes, megjithatë mund t'ia kërkojmë edhe një argumentim.

Këshilltare I.Nikaj: Z.këshilltar nuk ka qënë sistematik në prezencën e tij në mbledhje dhe për shkak të largimit të tij nga qyteti i Korçës do të ishte një përgjigje e tij edhe për mediat dhe për qytetarët.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës.

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-28 SHKURT 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj.Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I.Nikaj: Në bazë të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Kujdesit Social për muajin Shkurt, janë 45 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, "Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme" konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë

dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të njëjftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi-moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Për muajin Shkurt 2022, është në dispozicion fondi prej 229.840 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 45 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 114.026 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 25 familje, në shumën 31.552 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 145.578 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifike të miratuara 27 familje, me fond prej 79.750 lekë. I propozojmë Këshillit miratim të kësaj pike mbështetur në gjithçka është paraqitur në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" KUJTIM SHABANI-T.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Titujve të Nderit. Pandi Bello mund të vazhdoni.

Këshilltari P.Bello: Ne si Komision i Titujve të Nderit kemi diskutuar në bazë të gjithë dokumentacionit që na është vënë në dispozicion, ku mes tyre ishin edhe shkresa me opinione të vet popullit, se çfarë mendohej dhe vlerësimin që ata kishin për të dhe patjetër që jemi dakort për dhënien e këtij titulli.

Këshilltare A.Verushi: Ashtu siç tha edhe profesor Pandi ne si Komision kemi shqyrtuar dokumentat shoqëruese për doktorin e ndjerë z.Shabani të dorëzuara nga ana e Qendrës së Kulturës dhe kemi vetëm një korrigjim të vogël në projektvendimin e hartuar, ku neni 32 i shkruar tek materiali duhet të ishte neni 54 dhe jo 32, sepse nuk përputhen për atë ç'ka flet kjo pike, referuar ligjit të titujve të nderit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra, propozimi është që ky material të miratohet me ndryshimet e nevojshme që duhen bërë nga ekzekutivi?

Këshilltare A.Verushi: Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, kalojmë në votim atëherë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 147, DATË 22.12.2021, "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2022 TË BASHKISË KORÇË".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Kjo pikë i takon Komisionit të Financës dhe në fakt unë doja të tërhiqja vëmendje ndaj rendit të ditësedhe për ekzekutivin, pasi janë përfshirë në mbledhje më tepër materiale seç duhet sa i takon financës.Mesa po shoh Komisioni i Financës nuk është prezent sot kështu që besoj ekzekutivi mund të na thotë diçka më tepër për sqarim.

Ekzekutivi A.Dishnica: Pikanë fjalë është thjesht për ndryshimin e numrit të punonjësve të Bashkisë nga 425 punonjës në 428 punonjës për shkak të punonjësve të rinj në pozicionet e rojeve. Këto ndryshime përfshihen tek Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndryshime në të ardhurat për shkak të kësaj pike?

Ekzekutivi A.Dishnica: Nuk preken pasi bëhet fjalë për zëvendësime të planifikuara më parë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të pikës

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 137, DATË 25.11.2021, PËR "NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORCËS DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2022".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Meqënëse jemi në kushtet e mungesës së Komisionit të Financës, fjala do t'i jepet ekzekutivit për të bërë shpjegime e nevojshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po flas unë shkurtimisht meqënëse jam në dijeni të projektit që flitet në këtë material. Janë disa materiale në këtë mbledhje që lidhen me projektin e Tregut të Ri të

Gjesë së Gjallë të Bashkisë së Korçës. Ky është një projekt që ne po e zhvillojmë në bashkëpunim me financim të qeverisë italiane dhe është në kuadrin e përpjekjeve të viteve të fundit të Bashkisë Korçë për standartet e tregëtimit dhe të sigurisë në tregjet e ndryshme të qytetit të Korçës, siç ka qënë tregu i fruta-perimeve apo Markata e Shijes dhe siç është edhe ky treg i gjësë së gjallë që ne dëshirojmë ta kthejmë në një treg me standarte. Tregëtimi i gjësë së gjallë deri tani ka qënë i vendosur në aksin kombëtar turistik Korçë-Voskopojë pa përmbushur asnjë standart minimal ligjor për të ushtruar këtë veprimtari. Falë këtij investimi ne synojmë të vendosim disa kushte të pranueshme si për ata që tregëtojnë, edhe për blerësit, por edhe për konsumatorët. Siguria ushqimore është qëllimi kryesor. Jam shumë i kënaqur që edhe këtë pjesë të tregëtisë po e futim brenda standarteve që duhet, ndërkohë që çdo shpjegim tjetër mund ta gjeni në material dhe në materialet e tjera që janë pjesë e rendit të ditës.

Ekzekutivi Th.Koroveshi: Ky është një projekt i ndarë në disa hapa, të cilët ne i kemi ndjekur me shumë kujdes si në konsultim me shembuj të qyteteve të tjera ashtu edhe me studim të vendosjes së tarifës në bashkëpunim me gjithë grupet e interesit që preken nga ky projekt. Tarifat janë përshtatur edhe me tregjet e tjera ekzistuese në qytetin tonë, ato janë tarifa minimale në krahasim me kushtet dhe ato ç'ka do t'i ofrohen tregëtarit për aq orë sa do të rrijë aty gjatë ditës. 1m2 fillimisht do të paguhet 30 lekë me disa ndryshime në varësi të llojit të kafshës, tarifa të tjera janë llogaritur për mjetet e transportit, hyrjet dhe daljet e tyre dhe për shërbimin që do t'iu bëhet atyre, të gjitha këto të vendosura në përputhje me ligjin. Këto 4 muajt e fundit ne kemi patur herë pas here kontakte me blerës dhe shitës të atij tregu dhe reagimet kanë qënë pozitive.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët? Një kuriozitet nga ana ime, sipërfaqja si është menduar të administrohet?

Ekzekutivi Th.Koroveshi: Ka një standart që ndryshon në bazë të kafshëve për shernbull njëthundrakë zë një sipërfaqe prej 3.5 m2 e kështu me rradhë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE TË SHPENZIMEVE NË BUXHETIN E VITIT 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi mund të thoni diçka më tepër, këto dy pika lidhen me njëra tjetrën?

Ekzekutivi D.Tabaku: Po, këto pika në fakt janë në lidhje me njëra tjetrën, edhe kjo pikë lidhet me pikën e tregut të gjallë dhe të ardhura e parashikuara në material do të përdoren për shpenzimet e duhura për funksionimin e këtij tregu dhe konkretisht shpenzime personeli, shpenzime korrente dhe shpenzime për investime në treg, në programin “Shërbime bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve”, të detajuar si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore: shpenzime për paga 360,000 lekë; shpenzime për sigurime shoqërore 61,000 lekë; shpenzime korrente 678,000 lekë dhe shpenzime për investime (investime në treg) 653,000 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra, ky treg si markata për shembull do mbahet direkt nga Bashkia? Do arrijë të mbajë veten apo do e paguajmë ne akoma?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të ardhurat do i justifikojnë shpenzimet operative me një llogaritje që ne kemi bërë.

Ekzekutivi Th.Koroveshi: Në bazë të nevojës që mund të jetë, tregu mund të funksionojë edhe dy here në javë, kështu që ne themi se mund t'i arrijmë t'i mbulojmë të gjitha shpenzimet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po edhe nga pasqyra e parashikuar, të ardhurat mendohen të jenë në 1.7 milion lekë. Ai është një treg që nuk funksionon çdo ditë të javës kështu që edhe burimet tonë të përdorimit qoftë edhe në personel do të jenë të mirëmenduara patjetër, në mënyrë optimale, nuk është se po ngremë një strukturë me drejtorë dhe gjithë hierarkia me rradhë. Kemi edhe një pikë për mënyrën finale të operimit, po meqënëse mora fjalën po e sqaroj që tani. Ne jemi duke bërë një aplikim për të kërkuar financimin e një pjese të ngelur të këtij projekti tek skema financuese e qeverisë shqiptare për bujqësinë. Kërkesa për tek skema kombëtare është që nuk mund të aplikojnë bashkitë, por mund të aplikojnë shoqëritë aksionere që janë në pronësi të bashkive. Prandaj ne këtë aplikim do ta bëjmë nga SH.A e tregut të Fruta-Perimeve dhe në rast se finalizohet kjo kërkesë dhe ne marrim këtë financim, pastaj operimi i këtij tregu do të kryhet nga kjo SH.A dhe plotësohet struktura e kësaj shoqërie me ata dy, tre persona që do duhen për të operuar në këtë treg. Në rast se nuk financohet ky finalizim nga skema kombëtare jemi në variantin për ta menaxhuar nga një strukturë që do bëhet nga Bashkia. Këto janë ato dy opsionet e menaxhimit të këtij tregu. Ajo që është e rëndësishme edhe për publikun mendoj unë është kjo projekt do vihet në jetë dhe është shumë i rëndësishëm për tregëtimin e gjesë së gjallë dhe sigurisë ushqimore që duhet të kemi, sidomos në ditët e sotme që po dëgjojmë gjithë këto viruse të shpendëve dhe të gjesë së gjallë që bie here pas here.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

PËR RIALOKIMIN E FONDEVE PËR SHPENZIMET E KRYERA TË PROJEKTIT AUTHENTIKK ME FINANCIM TE HUAJ (IPA).

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ekzekutivi mund të merrni fjalën.

Ekzekutivi A.Shkodrani:Në kuadrin e Programit Interreg IPA i Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi- Shqipëri 2014-2020, Bashkia e Korçës ka fituar dhe është duke zbatuar projektin ndërkufitar, “AuthentiKK. Bashkia e Korçës është duke zbatuar këtë projekt me pikësypnim ndërhyrjen në infrastrukturë për tek Rruga e Bredhit të Drenovës dhe pikës së hedhjes me parashutë nga Mali i Moravës, kështu që kërkohet një pjesë të shpenzimeve të kalohen për kryerjen e këtyre investimeve.Duke zbatuar Marrëveshjen Financiare Interreg IPA të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi- Shqipëri 2014-2020, Ligjin Nr. 137/2016 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit European për Programin INTERREG IPA të Bashkëpunimit ndërkufitar GREQI-SHQIPËRI, 2014-2020”, Rregulloreve të miratuara nga Parlamenti European për implementimin e projekteve me financim nga Bashkimi European dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 4, datë 25.1.2021, pika 28 ku citohet “për njësitë e qeverisjes vendore , që kanë përdorur të ardhurat e veta për financimin e projekteve, fondi i rimbursuar nga donator/kreditori pas vlerësimit të përformancës sëprojekteve në fjalë, i kalon qeverisjes vendore që ka kryer shpenzimin nga të ardhurat e veta, në masën e shpenzimit të kryer, dhe përdoret prej saj si e ardhur”, kërkojmë mbulimin e shpenzimeve të papaguara të projektit.

Këshilltare A.Verushi: Kjo është një strukturë qëndiqet zakonisht në këto projekte, janë procese normale, ku shpenzimet kthehen pas nga investitori në një moment të dytë.

Këshilltare I.Nikaj: Ku janë këto pikat për të cilat bën fjalë materiali si vendndodhje?

Kryetari i BashkisëSotiraq Filo: Janë realizuar investimet në infrastrukturë tashmë, ndërkohë si vendndodhje flitet për pjesën nga Fusha e Dytë deri tek stacionet në Cezma e Ariut. Ndërsa për parashutën është ndërtuar sistemi tek kryqi, në majë të Moravës.

Këshilltare I.Nikaj: Meqënëse janë bërë ndërhyrjet mund të kishim ndonjë pamje të ndërhyrjes si është bërë.

Këshilltare E.Menkshi: Doja të pyesja nëse është menduar të vihen ato stacionet aty apo jo?

Kryetari i Bashkisë S.Filo; Në dijeninë tim ato janë private.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nëse nuk ka diçka për të shtuar mund të vazhdojmë me votimin.
Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës

MIRATIM FONDI PER PROJEKTIN "GJON MILI INTERNACIONAL VIDEO ART FESTIVAL".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi; Titulli i materialit nuk më duket shumë korrekt gjithsesi mund të vazhdojën ekzekutivi çfarë ka për të shtuar.

Ekzekutivi Z.Kita: Ju propozoj miratimin e kësaj pike si një mundësi fantastike për të gjithë të rinjtë e qytetit tone të cilët janë të apasionuar pas fotografisë, për më tepër që ky festival realizohet për here të pare dhe vjen si një risi për ne që jemi pjesë e artit dhe ku pretendohet dhe parashikohet një pjesëmarrje goxha e lartë e profesionistëve. Gjithmonë kemi patur mungesa në realizime të videove, reportazheve, fotove profesioniste dhe ky është një festival ku mund të spikaten të rinj të talentuar dhe profesionistë, unë ju ftoj të gjithëve ta miratoni.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 NË NIVEL PROGRAMI.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përpara se të marrë fjalën ekzekutivi në lidhje me këtë material doja të thoja se ne kemi realizuar edhe një sondazh që sugjeroj ta plotësoni dhe ta shpërndani edhe ju, ndërkohë të dhënat përfundimtare të tij mund të jenë të paraqitura herën tjetër.

Ekzekutivi D.Tabaku:Në zbatim të udhëzimit nr. 8 datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025" Bashkia Korçë ka përgatitur tavanet përgatitore të PBA 2023-2025 në nivel programi sipas formatit D1 të Instrumentit të Planifikimit Financiar.Tavanet e përgatitjes së PBA vendor 2023-2025 janë një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i

planifikimit të shpenzimeve të programit të jetë në përputhje me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike të NJVQV-së, është vendosja e taveve të shpenzimeve. Një "tavan" në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t'u shpenzuar për një qëllim të caktuar. Me alokimin e taveve të përgatitjes së PBA vendor 2023-2025 për programet buxhetore, Këshilli i NJVQV-së

garanton që shpenzimet të planifikohen në mënyrë që të buxhetojnë politikat, prioritetet, objektivat strategjike të NJVQV -së dhe të jenë në përputhje me alokimin strategjik të burimeve. Këto tave për Bashkinë Korçë janë ndërtuar për 7 programe të cilat përfshijnë 27 funksione dhe konkretisht si: planifikimi, menaxhim dhe administrim; siguria publike; shërbime publike vendore; arsimit; mbështetje e zhvillimit ekonomik; përkujdesja sociale; kultura, sport dhe argëtim. Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Korçë mbështetet në politikat fiskale të përcaktuara në Paketën Fiskale të Bashkisë Korçë të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr 137, datë 25.11.2021 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2022" e cila përcakton llojet e taksave dhe tarifave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Nëse flasim për transfertën e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale, këto transfertë për periudhën 2023-2025 do të jenë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2023-2025 dhe konkretisht transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme jepet për 2023 493,269 mijë lekë, me një rritje prej 31,192 mijë lekë ose 6.8% krahasuar me vitin 2022; për 2024 525,564 mijë lekë me një rritje prej 32,295 mijë lekë krahasuar me vitin 2023 ose 6.5%; për 2025 560,344 mijë lekë me një rritje prej 34,780 mijë lekë krahasuar me vitin 2024 ose 6.6%. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2023-2025 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar në buxhetin e vitit 2022. Transfertë e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me turizmin ka diçka që mund të veçohet se nuk dëgjova gjë?

Ekzekutivi D.Tabaku: Po, është përfshirë tek shpenzimet financiare që unë lexova.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Kalojmë në votim. Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 12 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË 30% TË TRUALLIT TË DHËNË PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT "SHITESË OBJEKTI REPART PRODHIM MERMERI NË DRENICË" NGA KRT KORÇË, ME VENDIM NR.380 DATË 12.09.1998 NË FAVOR TË Z.ARDİ FEZGA, PËR EFEKT REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë z.Gjergji Kristo mund të vazhdoni.

Këshilltari Gj.Kristo: Rasti konkret ka të bëjë me rregullimet nga VKMnr.329 datë 22.05.2019 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e mardhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi". Unë besoj se e keni parë materialin dhe subjektin në fjalë i mungon leja e lëshuar e miratimit për ndërtim para hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je. Nga verifikimet e bëra është konstatuar një mungesë dokumentacioni, konkretisht likuidimi i 30% të vlerës së truallit dhe akti i kalimit të pronësisë për 30% të truallit. VKM-ja parashikon se "Kur ka mangësi të dokumenteve të parashikuara më sipër, por për subjektin është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor, për dhënien e tokës për ndërtim, regjistrimi i pronësisë, kryhet pasi bashkia të ketë plotësuar mangësitë e dokuemnetacionit, apo të ketë përfunduar procedura e kalimit në pronësi, sipas këtij vendimi". Si dhe sipas pikës 11 të VKM-së 329/2019, kur subjekti nuk zotëron dokumentacionin e plotë të përcaktuar në pikën 6, të sipërcituar, por që ka të paktën vendimin e këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim, ka të drejtë ti paraqesë kërkesë bashkisë përkatëse për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë. I kërkohet Këshillit të Bashkisë Korçë të autorizojë kalimin e pronësisë së 30% të truallit prej 225 m² në favor të Z. Ardi Fezga, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës noteriale, bazuar në VKM-në 329/2019, për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ku bëhet fjalë si vendndodhje?

Ekzekutivi A.Dishnica: Në Drenica lart, vlera është siç ka qënë, kërkohet të paguajë diferenca 30% e shlyerjes së kontratës, në mënyrë që ta ketë në hipotekë pronën e lirë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë pse duhet të vinte deri në Këshill ky material?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këto janë struktura standarte që duhen realizuar, edhe baza ligjore se si duhet të paguhet ka dale kështu që do ndiqet rruga që duhet.

Këshilltari I.Nikaj: Në material thuhet që bashkangjitur gjendet edhe kërkesa e subjektit, është kërkesa bashkangjitur këtu?

Ekzekutivi A.Dishnica: Po, kërkesa është këtu e dorëzuar sipas formatit që ne kemi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, ka ndonjë diskutim tjetër për t'u shtuar? Atëherë si çështje u diskutua, por votimi do realizohet në një moment të dytë pasi nuk është kuorimi i nevojshëm 3/5 për ta votuar si pike.

Pika 13 e rendit të ditës

PËR SHITIMIN E OBJEKTIT TË VEPRIMTARISË TË SHOQËRISË AKSIONERE TREGU I SHITJEVE ME SHUMICË FRUTA-PERIME.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Këtu vazhdojmë si Këshill apo kalojmë si Asamble Aksioneri?

Ekzekutivi A.Dishnica: Veprojmë si asamble.

Përfaqësues të Tregut të Fruta-Perimeve: Objekti i aktivitetit të Tregut të Shitjeve me shumicë Fruta-Perime është ngritja dhe funksionimi i tregut të shitjes me shumicë të prodhimeve bujqësore të fresketa, dhënia me qera të hapësirave dhe ambjentëve të tregut, individëve që tregtojnë prodhime bujqësore, kryesisht fruta-perime. Dhënia me qera e hapësirave dhe ambjentëve individëve dhe firmave që sigurojnë shërbime të ndryshme për përdoruesit e tregut me shumicë. Ndërkohë Administratori dhe Këshilli i Administrimit bazuar në Ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nenin 9.1.6 germa b, 54/d Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Kodin Civil VKM 101 dt 9.2.2022, "Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022", i propozon asamblese që të shtojë objektin e aktivitetit si më poshtë: "Për ndertimin e tregjeve të kafshëve të gjalla, ngritjen, funksionimin dhe administrimin e tyre, organizimin e aktiviteteve tregtare, panaire etj".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Kalojmë në votim. Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 14 e rendit të ditës

(SIPAS KËRKESËS TË KORCA 2008 SH.A PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE) PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- Për emërtimin e dy ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2021 të shoqërisë "Korça 2008" sh.a.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe këtu do të vazhdojmë si shoqëri aksionere, le të na prezantojë administratori kërkesën dhe pastaj vazhdojmë me propozimet.

Administratori i Korça 2008 sh.a: Ne kemi paraqitur kërkesën tonë për emërtimin e dy ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2021 të shoqërisë Korça 2008 sh.a që ne përfaqësojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra, kërkon dy ekspertë kontabël, kemi ndonjë propozim ju lutem?

Këshilltari E.Muharem: Në emër të grupit socialist, ne propozojmë dy emra, siç janë znj.Ilda Ikonomi dhe znj.Etleva Ashiku.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Zakonisht kjo procedurë kërkon votim të fshehtë, por meqënëse janë vetëm dy emra ju ftoj t'i votojmë publikisht.

Këshilltare I.Nikaj: Të veprojmë sipas rregullave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, shpërndajmë fletët dhe secili të votojë, nëse keni propozime të tjera.

Këshilltare I.Nikaj: Problemi është se vota është individuale e fshehtë, këto kemi votuar gjithmonë, le ta ndryshojmë njëherë.

Hidhen në votim dhe miratohen të dy propozimet me vota individuale nga këshilltarët.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 15 e rendit të ditës

INFORMACION MBI GJETJET E BAROMETRIT GJINOR - BASHKI TË FORTA - PËR BASHKINË KORÇË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka dikush diçka për të shtuar për këtë informacion?

Këshilltare I.Nikaj: Diskutime mbi tema të tilla ne i kemi bërë gjithmonë dhe çështja shtrohet mbi arritjet dhe sfidat e barazisë gjinore në institucionet tona. Ajo që duhet patur parasysh nga të gjithë burra dhe gra është çështja e përpjekjeve maksimale të të gjithëve ne për të rritur treguesit e barazisë gjinore. Kërkohej trajtim i barabartë për të sjellë një demokratizim të shoqërisë dhe

institucioneve. Përparimi i grave në treguesit e barazisë gjinore do të thotë më tepër demokratizim, më pak korrupsion, më pak dhunë, më pak keqtrajtim të të gjitha vajzave dhe grave apo edhe qënies njerëzore në përgjithësi. Prandaj, unë këshilloj që këto statistika t'i marrim sëbashku me sfidat, t'iu japim përparësi disa prej këtyre sfidave, plotësimin e tyre, për të mos u dukur se po pakësojmë burrat dhe po rrisim gratë në institucione, por për të vendosur një lloj standarti në qeverisjen tonë. Pra, tek sfidat kam vendosur senuk sigurohet perfaqesim ne masen mbi 30% per secilen gjini në pozicionin Administrator (7 pozicione – zero grua); Bashkia nuk ka vendosur objektiva te ndjeshme gjinore vetëm në 27 programe të buxhetuara. Duhet të vendosen objektiva të ndjeshme gjinore në të gjitha programet; Bashkia nuk e di sa është raporti i shpenzimeve për politikat gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme dhe nuk e raporton këtë tregues, sipas Ligjit për “Financat vendore”; Bashkia nuk ka njësi performance; Bashkia nuk aplikon skema vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, sepse keto grante nuk jepen me nga NJQV; Bashkia mbledh statistika gjinore për 4 nga 9 funksionet, duhet të mbledhë për të gjitha funksionet në bazë të ligjit; Bashkia ka nëpunës vendor për çështjet e barazisë gjinore, por që mbulon edhe fusha të tjera; Buxheti gjinor; Bashkia ka vendosur tregues gjinore, të cilën e manaxhon Drejtoria e Sherbimeve Sociale dhe Shendetesore, por keto nevojiten per te gjitha programet e bashkise; Bashkia nevojitet te mbështete politika të zhvillimit të ndërmarrjeve sociale për gratë, gratë në zonat rurale, vajzat viktima të dhunës familjare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë të falenderoj për kujdesin, por mendoj se nuk ishte fare e drejtë që tek barometri u përmendën vetëm sfidat dhe jo arritjet. 50% e drejtorëve të Drejtorive janë gra, 100% të drejtorëve të departamenteve janë gra, patjetër që sfidat do t'i themi se ato na orientojnë për të ecur dhe për t'u përmirësuar, por edhe ato që janë arritur besoj se duhet thënë. Unë besoj se ne kemi bërë shumë për barazinë gjinore, duke nisur nga këto që përmenda brenda Bashkisë ku mendoj se janë më tepër të përfaqësuar sesa burrat. Bashkia e Korçës gjithmonë është përmendur për rezultate pozitive dhe për hapat që ajo ka marrë ndaj dhunës së grave, si prania e strehëzës për shembull e cila është funksionale, kemi një funksionim shumë të mirë të Komitetit Multidisiplinor që adreson gjithë problemet në familje tek organizata dhe donatorë që merren me këto çështje dhe për çështje të strehimit social e keni parë edhe vet çfarë trajtimi iu kemi bërë edhe në mbledhjet e Këshillit, me ndihmën në kriteret e vendosura dhe tek vemëndja ndaj kryefamiljarëve gra.

Këshilltare I.Nikaj: Unë e kam përmendur disa herë që duhej diskutuar njëherë çështja e barazisë gjinore dhe statistikave rreth tyre, megjithatë prapë mendoj se nuk është e vështirë të listosh meritat sa është e vështirë të evidentosh problematikat dhe sfidat. Nuk mendoj se kanë vlerë lavdërimet kur ka vend shumë për përmirësim. Detyra jonë është sigurisht për të punuar më mirë për qytetarët tanë. Kjo ishte përshtypja ime për të ecur në traditën e Korçës, për t'u kujdesur për vlerat e një shoqërie demokratike dhe të barabartë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shumë dakort jam edhe unë për të ruajtur vlerat e Korçës dhe për këtë arsye nuk doja të ngulmoja për të theksuar vlerat dhe traditat e Korçës, sepse janë mësa të qarta dhe për këtë arsye nuk duhet shfaqur situata aq negative siç e pasqyruat ju. Ajo që unë thashë

është se meqënëse ju keni marrë përsipër të nxirrni statistika dhe të dhëna nga barometri gjinor, nxirrini tamam dhe flisni edhe për gjërat pozitive që janë bërë në këtë Bashki, jo vetëm ato negative siç nisët dhe i listuāt, duke theksuar vetëm fjalën “nuk”. Ato që përmenda unë për % e drejtorive e me rradhë, nuk janë as tradita të Korçës dhe as që mburra Bashkinë thjesht fola realitetin që mund edhe t’i vlerësoni dhe keni parasysh.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të flas edhe unë dy fjalë tani, mos e kthejmë në debat. Unë e mirëkuptoj profesore Irenën për vëmendjen që ka ndaj çështjeve të tilla dhe bën përpjekjet e saj për këto statistika që ka pasqyruar. Nuk mendoj se duhet ta marrim kaq seriozisht këtë pjesën që Bashkia nuk ka bërë asgjë, siç nuk duhet të theksojmë probleme kaq të mëdha për barazinë gjinore, sepse ka patur përmirësim të dukshëm sidomos në vitet e fundit në Bashki. Sigurisht që duhet patur një qasje dhe qëndrim të qartë në mbështetje të këtyre çështjeve dhe duhen vlerësuar ato ç’ka janë bërë. Nuk mund të vazhdojmë replikë pas replike.

Këshilltare I.Nikaj: Po pra, dakort, por këto të dhëna janë nxjerrë nga pyetëtori që kanë plotësuar të gjithë punonjësit, nuk janë të nxjerra ashtu më kot. Pjesën e sfidave për të mos e zgjatur unë e përmenda për të krijuar një mjedis më pranues ndaj këtyre pjesëve pak më problematike për t’u trajtuar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po më vjen keq profesore që të dalësh para kamerës tani dhe të përmendësh gjithë gjërat me “nuk”, nuk mendoj se është korrekte. Unë nuk thashë ndonjëherë që këto sfidat nuk qëndrojnë, unë thashë që me vjen keq që gjithmonë theksohen pjesët negative dhe nuk vlerësohen ato pozitive. Tani ose thuaj të gjitha, ose mos thuaj asnjë, s’kishte këtu vend për t’u zgjatur apo jo.

Këshilltare I.Nikaj: Dakort, mendimi juaj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për ta bërë diskutimin më të gjerë, për shembull, në lidhje me pagat ka ndonjë të dhënë barometri, janë të njëjta apo jo?

Këshilltare I.Nikaj: Përgjithësisht kjo varet nga kategoria e punës, njësoj janë pagesat për të njëjtën kategori, si gratë dhe burrat, dallime të tilla nuk ka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e kishte tek paga profesorja dallimin, e kishte tek punësimi dhe meqënëse mu kujtua edhe një shembull kam dashur të promovoj një grua si administratore në një Njësi Administrative dhe ka qënë dështim total, pra s’mund të flasim më përgjithësi kur rastet janë specifike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përgjithësisht jam për zgjidhje natyrale, më të qëndrueshme dhe jam i sigurt profesore që bini dakort se zgjidhjet e sforcuara në këto vite të paktën që ne jemi aktivë nuk kanë qënë prezente.

Këshilltare I.Nikaj: Po shembujt tregojnë diçka tjetër si rasti i administratore që kryetari tregoi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ai ishte thjesht një shembull, në Bashkinë e Korçës sa kam qënë dhe sa do të jem unë në krye nuk do të ketë asnjëherë diskriminim gjinor për pozicionet e punës.

Pika 18 e rendit të ditës

INFORMACION NGA DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ky është një material i kaluar nga mbledhja e fundit, besoj e keni parë, ka ndonjë pyetje në lidhje me këtë çështje? Ka ndonjë shpjegim specifik nga ekzekutivi?

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo.

Pika 17 e rendit të ditës

KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Është zotëri që ka kërkuar të marrë pjesë në mbledhje po ai nuk është prezent këtu.

Kryetari i Bashkisë S.Filo : Zotëria më takoi mua personalisht, problemi i tij ishte mbi taksitë e paliçencuara dhe shqetësimin që i sjellin ato për linjën e tij të transportit të pasagjerëve, por ne, konkretisht policia bashkiake nga e cila ai kërkon të ndërmerren veprime nuk ka në kompetencë ligjore të bëjë kontrolle apo të marrë masa ndaj atyre që ai i quan taksi që punojnë në të zezë. Kjo është situata dhe përgjigjia që i është dhënë zotërisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi : Unë gjithmonë kam thënë që kur diskutonim për terminalin që këto çështje janë delikate dhe të vështira për t'u menaxhuar, duhet menduar mirë sesi do të veprohem me këto.

Një tjetër kërkesë lidhet me ndihmën financiare të një fëmije që vuan nga një sëmundje e rëndë, nuk po e lexoj sepse është pak e dhimbshme, nuk e di ekzekutivi është në dijeni ?

Kryetari i Bashkisë S.Filo : Unë personalisht nuk e dija rastin, tani e lexova, por ajo që mund të them tani është se nuk e di sa kapacitet financiar ka Bashkia për ta ndihmuar, duhet shqyrtuar si rast dhe mendoj se edhe Drejtoria e Kujdesit Social mund të bëjë verifikimet e tyre dhe pastaj të shohim çfarë mund të bëjmë për t'iu erdhur në ndihmë siç kemi bërë me rastet e tjera.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

